

# NJOFTIM

## Qendra e Personel Rekrutimit, do të rekrutojë kandidatë për ushtarë/detarë aktivë në FA

### Kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët për ushtarë/detarë aktivë:

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të mos jetë në ndjekje penale dhe në proces gjykimi;
- Të mos jetë i dënuar nga gjykata për vepra penale;
- Të ketë figurë të pastër morale dhe të mos ketë probleme me drogën dhe alkoolin;
- Të mos jetë i deportuar për kryerje të veprave penale;
- Të mos jetë kontingjent krimi dhe të mos jetë i evidentuar si i tillë nga organet ligjzbatuese;
- moshë minimale e rekrutimit është 18 vjeç. Në momentin e titullimit ushtarë/detarë aktiv nuk duhet të ketë mbushur moshën 27 vjeç, ndërsa për personelin mjekësor moshën 32 vjeç;
- Të ketë kryer arsimin minimum 9 vjeçar brenda ose jashtë vendit;
- Të ketë gjatësinë trupore mbi 165 cm për meshkujt dhe mbi 160 cm për femrat;
- Të jetë vlerësuar i aftë nga Komisioni Mjekësor Ushtarak;
- Të ketë rezultuar pa probleme gjatë verifikimit të kushtit të sigurisë të kryer nga strukturat përgjegjëse.

### Dokumentacioni që do të paraqesin kandidatët për ushtarë/detarë aktivë:

- Kërkesë me shkrim;
- Fotokopjen e kartës së identitetit;
- Formular i vetëdeklarimit;
- Dy fotografi të përmasave 4 x 6 cm dhe dy fotografi të përmasave 9 x12 cm;
- Fotokopje të noterizuar të çertifikatës së arsimit 9-vjeçar/ diplomës së arsimit të mesëm/ universitetit;
- Diplomë, dëshmi apo certifikatë për aftësitë profesionale (nëse ka), të noterizuara;
- Dokumenti i qendrës shëndetësore të lëshuar nga mjeku i familjes;
- Ekzaminimet mjekësore për agjentët infektivë (Hepatit B, Hepatit C, Sifiliz etj.), grupin e gjakut të lëshuar nga drejtoritë e shëndetit publik ose laborator mjekësor të licensuar për këto analiza;
- Vërtetim nga prokuroria, gjykata dhe dëshmi penaliteti.

Shtetasit që dëshirojnë të shërbejnë në FA si ushtarë/detarë aktivë do të aplikojnë: online nëpërmjet portalit e-Albania në shërbimin “Aplikim për rekrutimin e Forcave të Armatosura”, në postë, në seksionet e rekrutimit në qarqe si dhe në QPR.

Afati për regjistrimin e kandidatëve është deri më datë **15.08.2022**



**Adresa: Qendra e Personel Rekrutimit, Rruga e “Dibrës” (Ish-Shkolla e Bashkuar), Tiranë.**

**Kontakt: + 35542348588**

**Adresa e Facebook/Instagram  
Qendra e Personel Rekrutimit**

***Email: [info.qpr@aaf.mil.al](mailto:info.qpr@aaf.mil.al)***